




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	06.05.2022
REFERENCË:	01-463/06-0041894/22
PËR/ZA/TO:	znj. Blerina Kastrati - Udhëheqëse e Njësise së Komunikimit me Publikun / Zyra e Informimit
Cc:	z. Edison Tërnavë, inxh.Ark – Drejto
NGA/OD/FROM:	Xhevdet Aruqaj – Kryesues i Komisionit për hartimin e Draft-Rregullores për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së paluajtshme të Komunës për më pak se një (1) vit.
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shpallja e diskutimit publik



Me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës, duke u bazuar në nenin 68, paragrafi 68.3, të Ligjit për vetëqeverisje lokale; nenin 93 të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenin 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 Për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës; nenin 3 paragrafi 5, nenin 6 dhe nenin 7, paragrafi 1.3, të UA Nr. 06/2018 Për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, Komuna shpall:

DISKUTIM PUBLIK

Për Draft- Rregulloren për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës për më pak se një (1) vit.

Njoftohen të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara që të marrin pjesë në debatin publik, i cili do të mbahet ditën e enjte, me datë 19.05.2022, në Sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar nga ora 10:00.

Duke pasur në konsideratë rëndësinë e Draft-Rregullores për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës për më pak se një (1) vit, pjesëmarrja e publikut në këtë fazë të procesit është e domosdoshme, prandaj qytetarët dhe të interesuarit e tjerë nga dita e publikimit të këtij njoftimi, të gjitha komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe pikëpamjet mund t'i japin përmes e-mail adresës elektronike të Komunës së Mitrovicës komuna.mitrovica@gmail.com ose drejtpërdrejt te grupi punues i rregullores përmes kryesuesit të grupit punues z.Xhevdet Aruqaj (e-mail: xhevdet.aruqaj@rks-gov.net).

Bashkangjitur gjeni Draft-Rregulloren Komunale të miratuar nga Grupi punues për hartimin e Draft-Rregullores për +Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës për më pak se një (1) vit, i formuar me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës.